VENDIM
Nr. 126, datë 24.6.2025

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "SPV BLUE 2" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 dhe të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1496/9 prot., datë 16.6.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'SPV Blue 2' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për licencim

- Shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k. ka paraqitur në ERE, më datë 10.4.2025, kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 83, datë 24.4.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Në datat 25.4.2025 dhe 26.4.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit dhe deri më datë 5.5.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë pasur të tilla.

3. Dorëzimi i dokumentacionit dhe kërkesës për shtyrje te afateve

- Më 5.5.2025, shoqëria dorëzoi në ERE dokumentacion shtesë për aplikimin, si në mënyrë elektronike ashtu edhe fizike. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në ERE dhe korrespondencës me shoqërinë kjo e fundit më 19.5.2025, dorëzoi planin e biznesit të përditësuar dhe kërkoi disa ditë shtesë për dorëzimin e dokumentacionit financiar.

4. Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Në vijim të kërkesës së shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k., me e-mail-in e datës 15.5.2025, protokolluar në ERE me nr. 1497/6 prot., datë 19.5.2025, për shtyrje të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të mbështetjes financiare, me vendimin nr. 104, datë 23.5.2025, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

- Në vijim të njoftimit të këtij vendimi, përmes shkresës nr. 1497/9 prot., datë 3.6.2025, rezulton se shoqëria ka dorëzuar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit, përmes shkresës së protokolluar me nr. 1497/8 prot., datë 8.6.2025, nga shqyrtimi i të cilit mbetet ende për t'u sqaruar çështja në lidhje me strukturën organizative, mbështetjen financiare dhe disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit.

5. Shtyrja e afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të përditësojë informacionin/dokumentacionin në

lidhje me strukturën organizative, mbështetjen financiare dhe disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria duhet të përditësojë në ERE informacionin/ dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "SPV Blue 2" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti